

Gjergj Fishta

LAHUTA *e* MALCIS

antologji

Komentuar nga: Tonin Çobani



GJERGJ FISHTA
Lahuta e Malcis
antologji

V 11

LIBRARI
SHKENCOR
TIRANE
1966

Përgatitur nga:
Tonin Çobani

Shënimet filologjike:
Dr. Tefë Topalli



**Fishta, Gjergj: Lahuta e Malcis
antologji**

**Përgatitur nga:
Tonin Çobani**

Botim i dytë, i ripunuar.

**Arti grafik:
Elvira Çiraku**

**Botimet "Pakti" 2009
ISBN 978-99956-692-3-2**

**Vargjet janë zgjedhur nga Fishta, Gjergj "Vepra
letrare 4", Lezhë 2002,
"Lahuta e Malcis" dhe "Mojs Golemi" /
përg. Dr. Tefë Topalli.**

© Tonin Çobani

Seria: © Vepra të komentuar.

**Përzgjedhja dhe botimi:
Leka Ndoja.**

**Fotot historike:
Marubi**

“Lahuta e Malcis
është vepër arti e plotë, e përsosur
dhe e përkryer në vetvete”

Eqrem Çabej

Parathënia

Si lindi *Lahuta e Malcis*

1. Hyrje: kur shkruhej epopeja

Këngët e para të *Lahutës së Malcis*, që kanë si hero qendror Marash Ucin (me rreth një mijë vargje), Gjergj Fishta i shkroi në verën e vitit 1902 dhe i botoi si libërth më vete më 1904, ndërsa variantin përfundimtar të *Lahutës së Malcis* (me rreth 16 mijë vargje) e botoi më 1937.

Edhe në këtë këndvështrim, pra, të kohëgjatësisë, në të cilën u shkrua, *Lahuta e Malcis* është një vepër e veçantë, sepse autori i saj nuk e hoq nga dora për 35 vjet, ndërkohë që krijonte dhe botonte vepra të tjera të rëndësishme letrare e publicistike; ndërkohë që bënte një jetë politike dhe shoqërore tepër aktive, duke qenë protagonist i ngjarjeve të tilla, si: Kongresi i Manastirit (1908), Kryengritja e Përgjithshme për Pavarësi Kombëtare (1910-1912), Rrethimi i Shkodrës (1912-1913), Lufta e Parë Botërore (1914-1918), Konferenca e Paqes në Paris (1919-1920), Parlamenti i parë Shqiptar (1921-1924), Revolucioni Demokratik Borgjez (1924) etj.

Të gjitha këto pika kulmore të historisë së Shqipërisë janë reflektuar drejtpërdrejt në veprën letrare të Fishtës (kujtojmë këtu poezinë “Surgite mortui”-1920 dhe poemën satirike “Gomari i Babatasit”-1923) dhe janë pasqyruar gjerësisht në publicistikën e tij (revista “Hylli i Dritës”, gazeta “Posta e Shqypnis” etj), por ai i kthehej dhe i rikthehej *Lahutës së Malcis*, ndonëse zhvillimet historike në atë vepër ndalojnë me njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Si duket, Fishta ka menduar gjithmonë se kombi i ripërtërirë shqiptar do të kishte nevojë të përhershme të njëjtte rrënjët e veta epiko-historike, etno-kulturore e deri mitologjike. Dhe këto rrënjë të gjenit shqiptar (iliro-shqiptar), megjithëse të pashkruara deri atëherë (ose pjesërisht të thëna dhe të (sh)përdoruar prej kujtdo), janë më të thellat në truallin ballkanik në krahasim me të gjithë popujt e tjerë fqinjë të shqiptarëve, përfshirë sllavët, përballja me synimet ekspansioniste të të cilëve ndaj trojeve shqiptare përbën konfliktin kryesor të këngëve të para të *Lahutës së Malcis*, dhe ashtu mbetet edhe në variantin e saj përfundimtar kur ai konflikt zgjerohet duke përfshirë Perandorinë Osmane dhe kancelaritë diplomatike të shteteve më të fuqishëm të kohës.

Ky mesazh artistik i *Lahutës së Malcis*, për nevojën e njohjes së vazhdueshme të rrënjëve historiko-kulturore, është i rëndësishëm edhe sot, në kohërat moderne, kur shqiptarët dhe fqinjët e tyre të Ballkanit synojnë integrimin rajonal dhe më

gjerë, sepse integrimi (edhe globalizimi) nuk mund të realizohet duke fshirë kujtesën historike të popujve apo duke shuar kulturat kombëtare. Përkundrazi, pluraliteti i kulturave dhe i gjuhëve të popujve në Evropën e Bashkuar, përfshirë edhe kulturën dhe gjuhën shqipe, do të stimulohet, sepse, edhe pa njërën prej tyre, mozaikut kulturor të Evropës do t'i mungonte një ngjyrë.

2. Mitizimi i fillesës poetike

Si për çdo vepër tjetër madhore a zbulim me përmasa universale, edhe për *Lahutën* e Fishtës është kërkuar një frut që bie nga pema mbi kokën e dremitur të autorit për të zgjuar tek ai frymëzimin, si thuhet për mollën e Njutonit. Për Fishtën na kanë mbërritur dy tregime që e shpjegojnë zanafillën e *Lahutës së Malcis* si rastësi, me fjalë të tjera, janë dy përpjekje për ta mitizuar mesazhin artistik të epopesë kombëtare të shqiptarëve, që, në një farë mënyre, kanë shërbyer edhe për ta keqvlërësuar atë vepër letrare, duke thjeshtëzuar impenjimin e mundimshëm të krijimtarisë më se 35-vjeçare, duke e zhveshur veprën prej vlerave të papërsëritshme e krejtësisht origjinale, duke shkëputur autorin e *Lahutës së Malcis* prej “Zanës” së tij të Frymëzimit.

Tregimi i parë e shpjegon lindjen e idesë për t'u shkruar një vepër madhore si Lahuta e Malcis me takimin e rastësishëm të autorit të saj me malësorin e urtë, Marash Uci.

Gjergj Fishta, i lindur në fshatin Fishtë të Zadrimës më 23 tetor 1871 dhe shkolluar në Shkodër, në Troshan, dhe në Bosnje (Guçagora, Sustika e Livno) ku kreu studimet e larta për teologji e filozofi, filloi karrierën e priftit françeskan në Troshan (25 shkurt 1894), në Lezhë e Gomsiqe për t'u vendosur përfundimisht më 1902 në Shkodër. Shokët e tij e njohën si poet që në bankat e shkollës, por në shtyp u shfaq duke botuar poezi me pseudonime të ndryshme në revistën “Albania” të Faik Konicës në vitet 1899-1904. Pikërisht në këto vite (më saktë në pushimet verore të vitit 1902) ai u njoh më bariun, Marash Uci, kur ishte në Rapsh të Hotit për të zëvendësuar përkohësisht meshtarin e atjeshëm në shërbesat fetare.

Marash Uci (vdiq më 1914), malësori i pashkolluar, që kishte shërbyer si ushtar i Perandorisë deri thellë shkretëtirave të saj, i la Fishtës një përshtypje të veçantë për mënyrën si i gjykonte dhe i tregonte “historitë” e malësorëve, protagonistë të pafatë të ngjarjeve heroike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), ku Marash Uci kishte qenë edhe vetë një pjesëmarrës aktiv për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Kur Fishta u kthye nga Malësia, u tregoi miqve më të afërt vargjet që kishte shkruar atje për Marash Ucin. Ata do të këmbëngulnin që ato vargje të

botoheshin si libër më vete. Madje edhe e ndihmuan, së bashku me Faik Konicën, duke ndërmjetësuar te Ministria e Jashtme e Austrisë, për mbështetje financiare. Në vitin 1904/5 u botua në Zarë (Kroaci) libri i parë i *Lahutës së Malcis*. U botua pa emrin e autorit: “Lahuta e Malcis”, Kangë Popullore. Dy-tre vjet më vonë, më 1907 u botua libri i dytë “Vranina” me 4 këngë, kushtuar Oso Kukës. Ndërkohë që këta dy libra ribotoheshin (“Vranina” u ribotua 6 herë, ndërsa “Marash Uci” 4 herë, në dy botimet e fundit me titullin “Te Ura e Rrzhanicës”), Fishta shkruante këngët e tjera, të cilat filloi t’i botonte që nga viti 1921 deri më 1937, kur nxori nga shtypi variantin përfundimtar të *Lahutës së Malcis*. Që nga ajo kohë e deri më sot *Lahuta e Malcis* ka njohur disa botime brenda e jashtë vendit, është përkthyer qysh herët në gjermanisht dhe italisht (në të dy gjuhët disa pjesë janë përkthyer nga më shumë se një autor) dhe kohët e fundit edhe në anglisht.

Tregimi i dytë rreket të argumentojë se ideja për të shkruar *Lahutën e Malcis* i ka lindur Fishtës edhe më herët, pikërisht, kur ishte student në Bosnje, aty rreth viteve 1886-1893, pasi që njohur personalisht me lirikun kroat, Kranjçević Silvije Strahimir (1865-1908), të cilit në vitin 1892 i kushton edhe disa vargje të shkruar italisht; pasi ka mësuar përmendësh të gjitha vargjet e poemës “Smrt Smail Age Cengica” (Vdekja e Smajl Agë Cengiqit) të Ivan Mazhuranoviqit (1814-1890), të cilin e adhuronte shumë dhe pasi ishte njohur për së afërmi me veprat e autorëve të tjerë sllavë: Andre Kaçiq (1696-1769), Petar Petroviq Njegosh (1813-1851), Gërgo Martiq (1822-1905). Ata që sjellin argumente të tillë shkruajnë se Fishta njihte shumë mirë serbo-kroatishten dhe shkrimtarët që shkruanin në këtë gjuhë, prandaj i ndikuar prej veprave të tyre, “aty (në Bosnje) erdh idea e parë, me u vu me shkruar “Lahutën e Malcis”.

Sipas Fulvio Cordignano-s, në vitin 1925, Fishta po e realizonte idenë e hershme të *Lahutës së Malcis* me 20 këngë. Deri atëherë ishin shkruar 15 këngë, ndërsa pesë ishin në proces krijimi. Në projektin e 1925-ës *Lahuta e Malcis* fillonte me katër këngët e Oso Kukës (*Vranina*, ripunuar më 1923); vazhdonte me pesë këngët e *Lidhjes së Prizrenit*, botuar te revista “Hylli i Dritës” 1921-1923; pastaj vinin dy këngë me titull “Lugati” dhe “Kulshedra”, botuar më 1922 dhe dy këngë që do të shkruheshin (“Ora e Shalës” dhe “Ndokshiqi”); vijonin katër këngët nga *Marash Uci* dhe mbyllej me tri këngët e ciklit *Konferenca e Londonit*, që Fishta kishte menduar t’i shkruante (“Dedë Gjo Luli”, “Lufta e Ballkanit” dhe “Flamuri i Shqypnis”). Kënga e fundit, “Flamuri i Shypnis”, që, me sa dimë ne, nuk u shkrua ndonjëherë, do t’i kushtohej Princ Vedit.

Tanimë është i njohur fakti se ky projekt nuk u realizua, pasi Fishta, ashtu si Noli, Gurakuqi e të tjerë, pas dështimit të Revolucionit Demokratik Borgjez (dhjetor 1924) u larguar nga Shqipëria për t’u kthyer vetëm pas disa vitesh. Në

vazhdim ai ka menduar të tërhiqet, thujse krejtësisht, nga jeta politike e vendit për t'u marrë më me përkushtim me krijimtarinë e vet letrare, ku bënte pjesë edhe një projekt më i zgjeruar për *Lahutën e Malcis*. Kështu, në vitin 1930 shohin dritën e botimit pesë këngë të reja, kushtuar *Pater Gjonit*; më 1931 botohet si libërth më vete *Lidhja e Prizrenit* dhe më 1932 *Marash Uci*, varianti përfundimtar i *Lahutës së Malcis*. Më pas, gjatë viteve 1934-1935, Fishta do të botojë të "Hylli i Dritës" katër këngët për *Tringën* dhe tri këngë të *Konferencës së Londonit*. Dy këngët e tjera të këtij cikli do të shohin dritën e botimit vetëm në *Lahutën e Malcis* më 1937.

3. Çmitizimi: "Idhnim e t'çame krejtë me t'ba me dalun fejet"

Po të vazhdonim me logjikën e tregimit të parë, do të na duhej të shtonim edhe një hollësi tjetër, që lidhet me komunikimin maksimal që kanë pasur vargjet e Fishtës me vetë malësorët shqiptarë, që atëherë nuk dinin shkrim e këndim. Vargje të tëra nga *Lahuta e Malcis* mësoheshin përmendsh me një-dy herë të dëgjuara. Tregohet një rast domethënës, kur një malësor i pashkolluar deklamonte vargjet e plota të një kënge nga *Lahuta e Malcis*. E pyetën: si i kishte mësuar ato vargje kur nuk dinte shkrim dhe këndim? Ai u përgjigj se atë këngë e kishte dëgjuar një ditë rastësisht tek e lexonte me zë një i shkolluar: "Ia vuna mendën e m'u pelqye te s've". Kur e çoi në fund, iu luta të ma thote edhe një herë. Si ma tha së dyti, e mora krejt". Nga ky dimension homerik i vargjeve fishtjane, si dhe për shkak të mitit të krijimit të rastësishtëm të *Lahutës së Malcis*, ndoshta, kanë marrë nismë disa studiues, kryesisht të Pasluftës së Dytë Botërore, që e nënçmuan *Lahutën e Malcis*, duke e quajtur vepër thjeshtë "folklorike" dhe autorin e saj asgjë më tepër se një "rapsod popullor".

Ndërsa, sipas logjikës së tregimit të dytë, duhet shtuar se ka pasur studiues që kanë arritur në konkluzione edhe më të çuditshme, duke e etiketuar *Lahutën e Malcis* vepër të frymëzuar dhe të shkruar manastiresh ("kronike sterile"), apo duke "bërë përpjekje, – si vë në dukje studiuesi Safet Hoxha, – për të gjetur afri, analogji, po edhe reminishenca sllave në veprën *Lahuta e Malcis*". Reminishencë është kërkuar deri te titulli i veprës së Fishtës me atë të Petar Petroviq Njegoshit, "Gorskij Vjenac" (Kurora e Maleve) ose në krijimin e figurës së luftëtarit shqiptar "sipas modeleve sllave (sic!)" etj.

Është për t'u shënuar se vetë Fishta nuk merakosej shumë për çfarë (do të) shkruanin dhe (do të) thoshin të tjerët për të dhe veprën e tij. Ai ishte i bindur se kishte krijuar një përmendore "rr'fé as mot mos m'e dermue". Dhe gjatë kohës që punonte për "Përmendoren" e tij dhe të shqiptarëve, më keq se të thënat e të shkruarat, atij i kishin shkaktuar qëndrimet e mediokërve ("krye-kungujt") që kishte mbi kokë.

Në këngën e fundit të *Lahutës së Malcis*, në dialog me “Zanën e Frymëzimit” (“Hej, moj Zanë, ti qofsh e bardhë”), Fishta flet për të tridhjetë vitet e tij “purë (përkulë) n’Lahutë t’Malcis”, duke u rrekur “sa u tuer (u tjerr) rrena edhe tradhtia” e duke u përplasur “mriz e n’mriz e lak në lak”. Ky varg i fundit është domethënës për të kuptuar se frymëzimi i tij ka rrjedhur edhe mundimshëm vargjeve “kreshnike” të *Lahutës së Malcis* “t’u regjë mendja e shqiptarit\ prap për t’gëzue lirinë jetike”. Dhe ajo “liri jetike”, që u kishte munguar shqiptarëve ndër shekuj, i kishte munguar edhe njeriut që mori përsipër të këndojë në gjuhën shqipe rodin e shqiptarit për një periudhë të gjatë kohore, më se 35-vjeçare. Madje, vazhdon t’i mungojë bash për shkak se po shkruan një vepër origjinale, me përmasa të tilla si *Lahuta e Malcis*, duke kaluar nga njëri rrezik në tjetrin (“lak në lak”).

Njërin prej këtyre rreziqeve (apo pengesë serioze) na e fillon studiuesi i njohur Injac Zamputi. Ai na kumton një fakt, ndonëse jashtëletrar, por mjaft bindës për të kuptuar lakun në fytin e poetit, ndërkohë që shkruante *Lahutën e Malcis*. Atë lak ia mbanin lidhur në qafë deri vetë eprorët e Urdhrit të tij Françeskan, ndërkohë që ia lavdëronin publikisht veprën dhe mitizonin fillesat e vetvetishme poetike. Duke iu referuar gjithnjë studiuesit Injac Zamputi, këta eprorë, kryesisht me kombësi jo shqiptare, të cilët Fishta i quan *krye-kunguj*. “sipas rregullave të Urdhrit (Françeskan), i kërkonin atij punë të tjera, duke ia penguar punimet poetike. Dhe, pse jo? i kërkonin të hiqte dorë nga idetë dhe veprimtaritë kombëtare”.

Është viti 1916, kur Fishta e ndien veten kaq tepër të rënduar prej qëndrimeve të tilla, sa shprehet në disa vargje, mbetur dorëshkrim diku në një libër të tij, se nuk përfitoi asgjë për këngët e *Lahutës së Malcis*, që kishte shkruar deri atëherë, veçse “idhnim e t’çame krejet me t’ba me dalun fejet”.

Dhe, pavarësisht nga të gjitha këto kokëçarje jo të vogla, geni i poetit të Fishta dhe vullneti i tij shembullor, nuk reshtën së krijuari *Lahutën e Malcis*. Edhe për këtë fakt kemi të bëjmë me një vepër të madhe dhe të papërsëritshme në llojin e vet. Ai i përjetonte për një kohë të gjatë brenda vetes emocionet e fuqishme të heronjve epikë të *Lahutës së Malcis*, prandaj vargjet i shkruante kudo e në çdo kohë: kur e dërgonin famullive të largëta (cikli i *Marash Ucit* u shkrua në Hot); kur bënte udhëtime të gjatë (dihet se “Lugati” u shkruar kur udhëtonte në një anije për në Amerikë); kur kishte nevojë të çlodhej nga punët e rëndomta e vinte në Lezhë, ku dihet se ka shkruar njërën prej këngëve më të bukura të *Lahutës së Malcis*, atë me titull “Koha e Re” etj. Njohja e rrethanave specifike individuale të realizimit të krijimtarisë ka një rëndësi të dorës së parë për studiuesit, veçanërisht, kur kërkohet të depërtohet thellësisht të përfitesave artistike të fjalës apo vargut të një vepre letrare si *Lahuta e Malcis*, ashtu si marrin rëndësi të konsiderueshme edhe veprimtaria shoqërore e autorit, formimi

i tij kulturor, idetë në raport me kohën dhe preokupimet gjithfarëshe të jetës së përditshme. Në rastin e Fishtës duhen vlerësuar edhe rrethanat historike e politike të mjedisit shqiptar: ciklet e *Marash Ucit* dhe të *Oso Kukës* u shkruan në kushtet e robërisë pesë shekujllorë; cikli *Lidhja e Prizrenit* u shkrua pas Konferencës së Paqes së Parisit; ciklet e *Pater Gjonit* dhe të *Tringës* u shkruan pas shpalljes së Monarkisë; ndërsa e vepra e plotë u botua me rastin e 25-vjetorit të Pavarësisë (1937).

Por edhe pasi e kishte bërë botimin e plotë të *Lahutës së Malcis*, Fishta nuk u nda prej veprës së vet. Ai mendonte ta rishikonte sërish atë vende-vende. Një dëshmi e Viktor Volajt thotë se “dy muej para deket, qortuem bashkë me Poetin (Gjergj Fishta) tremëdhjetë kangët e para të *Lahutës (së Malcis)*”. Është kuptimplote edhe dëshmia tjetër që ka ardhur në formën e amanetit letrar të Fishtës në çastet e fundit të jetës, kur përmend *Lahutën e Malcis*, nevojën për të shkurtuar ende disa vargje te kënga e parë dhe “lirimin prej përsëritjeve” të këngëve të fundit.

Lexuesi i këtyre radhëve, duhet të ketë arritur në përfundimin se një vepër madhore si *Lahuta e Malcis*, mbi të cilën poeti ka punuar thuajse gjatë gjithë jetës së tij, as sesi nuk mund të justifikohet me tregime që shpjegojnë fillesat e saj si rastësi, as të gjykohet duke e krahasuar me shabllone veprash të krijuara në rrethana të ndryshme kohore e mjedise etno-kulturore të tjera. Ajo duhet pranuar siç është, duhet studiuar në lidhje me gjuhën, në të cilën u krijua dhe zërin me të cilën u këndua/deklamua tubimesh apo në mënyrë individuale. *Lahuta e Malcis* duhet pranuar së bashku me autorin e saj që e mbajti në gji aq gjatë sa çdo këngë e varg u identifikua me shpirtin e tij dhe të popullit që e kishte dhe e ka. *Lahuta e Malcis* është vetë modeli i eposit poetik kombëtar, një poemë me vlera artistike të papërsëritshme, që, “porsi vena e mirë, sa ma shumë vjet që kalojnë aq ma vlerë merr” (Lambertz) .